

FEDERATA E PINGPONGUT TË KOSOVËS (FPPK)

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2024

Prishtinë, Prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Përmbajtja	2
Shkurtesat	3
Informatat e përgjithshme	4
Deklarata e pajtueshmërisë	5
Raporti i auditorit të pavarur	6-7
Pasqyra e pozicionit financiar	8
Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse	9
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	10
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	11
Shënimet e pasqyrave financiare	12-21

Shkurtesat e përdorura

SNA-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

SNK-Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

SKK-Standardet Kosovare të Kontabilitetit

SNRF-Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës

ITTF - Federata Ndërkombëtare e Pingpongut

ETTU - Unioni Evropian i Pingpongut

BTTU - Unioni Ballkanik i Pingpongut

MTTU – Unioni Mesdhetar i Pingpongut

KOK - Komiteti Olimpik i Kosovës

Informatat e përgjithshme

Bordi ekzekutiv:

Jeton Oruqi, Kryetar

Alban Azemi

Alma Mehmeti

Besim Hajdari

Blerina Boshnjaku

Blerina Sallaj

Dardan Imami

Feim Rama

Kreshnik Dacaj

Qamil Vishaj

Shega Hashani

Sekretar i përgjithshëm i Federatës

Fadil Luta,

Zyra e regjistruar:

Shtëpinë e Sporteve

Rr. Agim Ramadani, nr. 253, zyra nr. 7

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Bankat:

Banka për Biznes, filiali Prishtinë

Auditor:

Xhemail Syla

Auditor Ligjor

Rifat Mziu nr. 13

10000 Prishtine

Republika e Kosoves

Tel: +383 44 156 921

Email: xhemailsyla@gmail.com

Federata e Pingpongut e Koovës

Shtëpinë e Sporteve

Rr. Agim Ramadani, nr. 253, zyra nr. 7

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Deklaratë e Pajtueshmërisë

Deklarojë që pasqyrat financiare për vitin raportues 31.12. 2024 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve si dhe rrjedhës së parasë, dhe pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si dhe Ligjeve ne fuqi ne Republliken e Kosovës.

Datë: 10.03.2025

Prishtinë

Kryetari i Bordit

/Jeton Oruçi/

Drejtori Financiar

/Fadil Luta/

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Bordin dhe Menaxhmentin e Federatës së Pingpongut të Kosovës

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Federata e Pingpongut e Kosovës” Prishtinë, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2024, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të organizatës me 31 dhjetor 2024, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti.

Jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgatit mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vetë për 12 muajt e ardhshëm.

Për detyrimet të cilat subjekti i ka 2 vite me radhe, subjekti zotohet se gjatë vitit 2025 do t'i shlyej. Me shikimin e pagesave në vitin 2025 deri në datën e raportimit të opinionit tonë, kanë mbetur edhe afër 8000 mij euro të cilat sipas zotimit të subjektit do të shlyhen deri në fund të Qershorit 2025

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare

Informacione tjera, financiare ose jo financiare që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra, të përfshira në raportin vjetor të entitetit dhe kanë mospërputhje materiale me PF ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e PF dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk janë identifikuar.

Përgjegjësitë e drejtimi dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrollin e tilla të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare


Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfaqëson opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidencat të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e drejtimit dhe bazuar nga evidencat e përfuara të auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Xhemail Sylja
Auditor Ligjor
Rifat Mziu nr. 13
10000 Prishtine
Republika e Kosoves
Tel: +383 44 156 921
Email: xhemailsyla@gmail.com
22.04.2025

XHEMAIL SYLA
Auditor Ligjor
Statutory Auditor
044/156 921 Prishtinë

Federata e Ping Pongut e Koaovës

Pasqyra pozitës foinanciaree, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në euro)

	Shënime	31 dhjetor 2024 (në EUR)	31 dhjetor 2023 (në EUR)
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtëra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3	3,581	6,987
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		-	-
Pasuritë tjera afatshkurtëra		-	-
Gjithësej pasuritë afatshkurtëra		3,581	6,987
Pasuritë afatgjata		-	-
Prona dhe pajisje	4	32,480	-
Pasuritë tjera afatgjata		-	-
Gjithësej pasuritë		32,480	2,446
GJITHËSEJ PASURITË		36,061	9,433
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtëra			
Kreditë dhe Huatë			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	5	77,995	18,096
Gjithësej detyrimet afatshkurtëra		77,995	18,096
Detyrimet Afatëgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjate		-	-
Detyrime tjera afatgjate		-	-
Gjithësej detyrimet afatgjata		-	-
GJITHSEJ DETYRIMET		77,995	18,096
EKUITETI			
Fondi i bartur me 01.01	6	(8,672)	9,153
Teprica/mungesa e fondit		(33,262)	(17,816)
Gjithësej ekuiteti		(41,934)	(8,663)
Gjithësej detyrimet dhe ekuiteti		36,061	9,433

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe nënshkruan me datë 10 mars 2025 ne emër të FPPK-së nga:

Jeton Oruçi
Kryetari i FPPK

Fadil Luta
Udhëheqësi financiar

Shënimet nga 3 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Ping Pongut e Koaovës

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë në euro)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 (në EUR)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 (në EUR)
TË HYRAT			
Të Hyrat për projekte	7	306,088	132,046
Sponsorizim		12,000	1,000
Të hyrat tjera		1,050	120
Gjithsej të hyrat		319,138	133,166
SHPENZIMET			
Shpenzimet programore	8	(244,202)	(148,951)
Shpenzimet e zhvlerësimit	9	(12,599)	(421)
Shpenzime të tjera operative	10	(10,506)	(1,610)
Shpenzime per paga dhe meditje	11	(84,791)	
Teprica/Ulja operative		(32,961)	(17,816)
Të ardhura financiare			-
Shpenzime financiare		(301)	-
Teprica/Ulja e vitit		(33,262)	(17,816)

Shënimet nga 3 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Ping Pongut e Koaovës

Pasqyra e ndryshimeve në fonde, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë në euro)

	Tepriat /(Uljet) e Mbajtura (në EUR)	Rezervat e tjera (në EUR)	Gjithësej (në EUR)
Pozicioni financiar më 1 janar 2022	23,801	-	23,801
Teprica/Mungesa i/e vitit	-14,648	-	-14,648
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	9,153	-	9,153
Teprica/Mungesa i/e vitit	-17,816	-	-17,816
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	-8,663	0	-8,663
Teprica/Mungesa i/e vitit	-33,262		-33,262
Diferencat nga rrumbullaksimet		-9	-9
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	-41,925	-9	-41,934

Shënimet nga 3 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

Federata e Pingpongut te Kosovës
Pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024

Federata e Ping Pongut e Koaovës
Pasqyra e flukseve monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative</i>			
Fitimi/Humbja para tatimit		-33,262	(17,816)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		12599	421
Amortizimi i pasurive të paprekshme			-
Fitim nga shitja e pronave dhe pajisjeve			-
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		-20,663	(18,237)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet</i>			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera			-
Pasuritë tjera afatshkurtëra			-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		59,890	18,096
Detyrimet tjera afatshkurtëra			-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative		59890	18,096
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese</i>			
Pagesat për blerjet e pronës dhe pajisjeve		-42633	(349)
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			-
Arkëtimet nga shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve			-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investuese		-42633	(349)
<i>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</i>			
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë			-
Ripagimi i kredive dhe huave			-
Pagesat tjera financiare			-
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese		0	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të saj		-3,406	(2,143)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		6,987	9,130
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	3	3,581	6,987

Shënimet nga 3 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare.

1. Hyrje

a) Korniza ligjore

Federata e Pingpongut të Kosovës (FPPK) është regjistruar pranë Qendrës për themelimin e OJQ-ve në Prishtinë me 18/12/2000, me NRB 5100503-1.

Federata e Pingpongut të Kosovës, është themeluar konform rregullave të nenit 2.2 të Rregullores nr. 1999/22 të cilat janë zëvendësuar me: Ligjin Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe Ligjin nr. 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. FPPK është organizatë joqeveritare dhe jo profitabile.

Në përputhje me rregullat e nenit 4 të Ligjin nr.03/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e saja përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse. Po ashtu nuk përdoren për të sjellë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, nëpunës, anëtar, punonjës ose donator të Qendrës. Mirëpo nuk pengon pagesën a kompensimin e arsyeshëm për personat që e kryejnë punën për qendrën.

b) Statuti

FPPK, veprimtarinë e vet e ka të rregulluar sipas Statutit të cilin e ka aprovuar me datën 03.09.2011, e përmirësuar me datë 11.02.2020, 22/09/2022 si dhe me datë 14/12/2024

Rregullat e këtij statuti përshkruajnë se:

- FPPK të quhet Federata e Pingpongut e Kosovës (neni 1).
- FPPK është Shoqatë jofitimprurëse (neni 5 pika 1).
- **Themelues të FPPK janë: Klubet e pingpongut**

Përfaqësues i autorizuar i FPPK është: Kryetari Jeton Oruqi, Prishtinë, Kosovë (neni 16 pika 12.10).

FPPK është organizatë sportive e pavarur, joqeveritare përmes së cilës realizohen caqet e përbashkëta dhe detyrat e zhvillimit dhe përparimit të sportit të pingpongut në Republikën e Kosovës (neni 3).

FPPK është e fokusuar në këto aktivitete:

- Zhvillimi i sportit të Pingpongut në Kosovë,
- Përcaktimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore të sportit të Pingpongut,
- Harmonizimi i aktiviteteve të klubeve, shkollave dhe seksioneve të Pingpongut,
- Propozimi i programeve të aktiviteteve të Pingpongut si nevoja publike,
- Mbështetja në realizimin e programeve publike në sportin e Pingpongut,
- Përcaktimi i politikës për mbrojtjen e cilësisë kulmore/ të lartë të sportistëve,
- Mbështetja e punës profesionale dhe aftësimi i personelit profesional të sportit të Pingpongut,
- Mbështetja për kushtet e përgatitjeve të sportistëve kulmor për Lojërat Olimpike, Kampionatet Evropiane dhe Botërore dhe garat tjera ndërkombëtare,
- Përcaktimi i formës së garave dhe kushteve të organizimit të garave në Pingpong,
- Mbështetja në sigurimin e mjeteve për sigurimin e aktiviteteve afariste dhe të tjera.

- Anëtarët e FPPK-së janë klubet e Pingpongut (private dhe publike) që veprojnë në Republikën e Kosovës (neni 7).
- Kuvendi i FPPK-së (ne tekstin e mëtejme: Kuvendi) është organi më i lartë i FPPK-së i cili drejton punën e FPPK-së.
- Kuvendi zgjedhë Organet dhe Komisionet e veta (neni 15).
- FPPK ndërpret punën në pajtueshmëri me dispozitat ligjore ose kur Kuvendi vendos me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 40).
- Bordi i FPPK-së, miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare dhe ia dërgon Kuvendit për miratim (neni 16).

Paraqitja e pasqyrave financiare për vitin i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2024 është aprovuar më 31 janar 2024 nga kuvendi i Federatës.

2. Përmbledhja e politikave domethënëse të kontabilitetit

2.1 Përmbledhje

Federata e Pingpongut e Kosovës (në tekstin e mëtejme: FPPK) është organizatë sportive e pavarur, joqeveritare përmes së cilës realizohen caqet e përbashkëta dhe detyrat e zhvillimit dhe përparimit të sportit të pingpongut në Republikën e Kosovës.

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të FPPK-së janë përgatitur nga të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM), të cilat i përfshijnë standardet dhe interpretimet e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe interpretimet nga Komisioni Ndërkombëtar për Interpretimin e Raportimit Financiar të miratuara nga Komisioni i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK) të cilat janë në fuqi.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

Të dhënat rrjedhëse dhe ato komparative janë vlerësuar dhe janë paraqitur në njësinë monetare “euro”, përveç nëse kërkohet ndryshe.

2.3 Vazhdimi i aktiviteteve

Aftësia e FPPK për t'i përmbushur obligimet e saja sipas gjendjes momentale dhe pohimeve të BORDIT është e qëndrueshme.

Pasqyrat financiare të Federatës janë, përgatitur sipas parimit që OJQ-ja ka vazhduar me aktivitetin e saj deri më 31 dhjetor 2024, si dhe do të vazhdojë deri në kohën e paraqitjes së pasqyrave financiare për vitet pasuese.

2.4 Shfrytëzimi i përllogaritjeve (vlerësimet e përafërta)

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtim me SNRF-në, kërkon nga BORDI që t'i kalkulojë dhe t'i supozojë ashtu që të ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe të detyrimeve (obligimeve) dhe paraqitjen e pasurive kontingjente (të jashtëzakonshme) dhe detyrimeve në ditën e paraqitjes së pasqyrave financiare si dhe të shumave të raportuara për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë periudhës së raportimit.

Rezultatet e tanishme nuk parashihet të ndryshojnë nga ato të përllogaritura.

2. Përmbledhja e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

2.5 Inventari, Pajisjet dhe Veturat

Pasuritë janë bartur gjatë vlerësimit, që determinohet si në vijim:

Për pasuritë e fituara nga donacionet për Federatën që nga themelimi pra në vitin 1953 e deri më tani, zërat e pajisjeve janë marrë me çmim kushtues duke zbritur cilindo zhvlerësim pasues të akumuluar dhe cilëndo humbje pasuese nga dëmet.

Vlerësimin në tërësi të inventarit, pajisjes dhe të veturave.

Vlerat që e bartin inventari, pajisja dhe veturat, janë shqyrtuar për shkak të dëmeve, kur ngjarjet ndryshojnë ose kur rrethanat e ndryshuara tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e riparueshme. Nëse ekzistojnë tregues të këtillë dhe kur vlerat bartëse e tejkalojnë shumën e përlogaritur të riparimit, këto pasuri ose njësitë monetare në qarkullim janë regjistruar në shumën e tyre të riparueshme.

Gjatë përcaktimit të vlerës përdoruese, rrjedhjet e përlogaritura të parasë së gatshme në të ardhmen zbriten deri në vlerën e tyre të tanishme, duke zbatuar përqindjen e skontimit para zbritjes së tatimit që i reflekton vlerësimet e tanishme të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqet specifike për pasuritë (mjetet). Për një mjet (pasuri) që në masë të madhe vetvetiu nuk i vë në qarkullim rrjedhjet e parasë, shumat e riparueshme përcaktohet për njësinë monetare në qarkullim të cilës i përketin pasuritë. Humbjet nga dëmet, regjistrohen në bilancit e suksesit.

Zhvlerësimi llogaritet sipas metodës lineare dhe në pajtim me shkallët e përcaktuara si në vijim:

Ndërtesat	5%
Makina dhe pajisje	20%
Automjete	20%
Kompjuterë	20%

2.6 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në bankë dhe paratë e gatshme në arkë.

2.7 Përfitimet e punonjësit

FPPK -ja, nuk i kontribuon planeve të periudhës pas pensionimit të punonjësve të saj, ashtu siç është përshkruar nga legjislacioni i Republikës së Kosovës për sigurimin social.

Kontributet në bazë të pagave, janë bërë për organizatat vendore, të cilat janë përgjegjëse për pagimin e pensioneve. Nuk ka përgjegjësi tjetër lidhur me këto plane dhe si të tilla këto skema konsiderohen si plane të përkufizuara për kontribute.

FPPK nuk përfiton nga punonjësit e saj pas periudhës së pensionimit.

2.8 Tatimi

Pasi që është themelatë jofitimprurëse dhe OJQ edhe nëse realizon të ardhura neto nuk i nënshtrohet obligimeve tatimore për tatimin në profit (pika 4 e nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-057 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare si dhe nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

2.9 Instrumentet financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare të paraqitura në bilancin e gjendjes përfshijnë: Paranë e gatshme si dhe ekuivalentët e parasë.

Politikat e kontabilitetit lidhur me futjen dhe vlerësimin e këtyre zërave janë të njohura (publike) në politikat përkatëse të kontabilitetit të përfshira në këtë shkresë. Instrumentet financiare janë klasifikuar si pasuri (mjete), detyrime ose kapital në pajtim me përmbajtjen e marrëveshjes kontraktuese.

Fitimet dhe humbjet lidhur me instrumentet financiare janë të klasifikuara si pasuri ose detyrime janë raportuar si të hyra, përkatësisht si shpenzime. Instrumentet financiare kompensohen kur shoqata ka të drejtën ligjore të zbatueshme për të kompensuar dhe synon që këtë ta shlyej, qoftë sipas madhësisë neto ose ta realizojë mjetin dhe njëkohësisht ta shlyej detyrimin.

2.10 Provizionet dhe kontingjentet

Provizionet merren kur FPPK tashmë ka një obligim ligjor si rezultat i një gjendjeje të mëparshme dhe ka mundësi që rrjedhja e burimeve e cila i materializon përfitimet ekonomike të kërkojë shlyerjen e obligimit si dhe një përlllogaritje të besueshme mund të bëhet në shumën e atij obligimi. Provizionet rishikohen në çdo bilanc të gjendjes dhe korrigjohen për të pasqyruar vlerën e tanishme të shpenzimeve të cilat priten të shkaktohen për ta shlyer obligimin.

2.11 Shëndërrimi në valutë të huaj

Vlerësimi dhe paraqitja e Pasqyrave Financiare të qendrës bëhet në valutën euro. Transaksionet të cilat i përfshijnë valuat e huaja regjistrohen sipas kursit i cili ekziston në ditën e transaksionit. Pasuritë monetare (nominale) dhe obligimet të denominuara në valuta të huaja vlerësohen sipas kursit të këmbimit i cili ekziston në ditën e bilancit të gjendjes. Diferencat që rezultojnë nga shkëmbimi, janë paraqitur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

2.12 Vlerësimi i të ardhurave

Të ardhurat janë fituar nga donatorët jashtë Kosovës të cilat donacione kanë qenë: nga qeveritë dhe nga Shoqëria civile.

I.PASQYRA E BILANCIT

3. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paratë e gatshme	5	85.89
Paraja në bankë	3,576	6,900.98
Gjithësej	<u>3,581</u>	<u>6,986.87</u>

Paraja e gatshme tek bankat realizon fitim nga kamata në shkallët fikse dhe e cila kamatë përcaktohet nga secila bankë në mënyrë individuale si dhe mund të ndryshohet me vendimin e tyre. Këto mjete janë në llogarinë bankare BPB.

Federata e Pingpongut te Kosovës

Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024

4. Prona dhe pajisje

	<u>Pajisje dhe Makineri</u>	<u>Ndertesa</u>	<u>Totali</u>
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2022	5,643.83	-	5,643.83
Shtesa	360	-	360
Transferime	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	6,003.53	-	6,003.53
Shtesa	349	-	349
Transferime(shitje)	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	6,353	-	6,353
Shtesa	42,633	-	42,633
Transferime(shitje)	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	48,986	-	48,986
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2022	3,485	-	3,485
Zhvlerësimi i vitit	421	-	421
Kthim amortizimi	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,906	-	3,906
Zhvlerësimi i vitit	12,599	-	12,599
Kthim amortizimi	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	16,505	-	16,505
Vlera neto e asetëve 31 Dhjetor 2023	2,446	-	2,446
Vlera neto e asetëve 31 Dhjetor 2024	32,480	-	32,480

Federata e Pingpongut te Kosovës**Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2024****5. Llogaritë e pagueshme tregtare**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogaritë e pagueshme tregtare	77,995	18,096.07
Gjithësej	77,995	18,096.07

Llogaritë e pagueshme ju përkasin obligimeve që FPPK-ja ka ndaj bashkëpunetorëve që kanë ndihmuar në përmbyllje të projekteve, e pritet ti shlyejë këto obligime në periudhën në vijim.

Obligimet ju përkasin këtyre anëtarëve:

Nr.	Huadhënësi / Furnitori / Paga	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
1	Pagat dhe meditet	20,669	7,793.47
2	Furnitorët / Huazimet	52,540	10,303
3	Detyrimet per tatime	2,337	
4	Detyrimet per kontribute pensionale	2,459	
Total		77,995	18,096.07

Të hyrat e shtyra janë determinuar sipas kriterit të efektit të kompetencës së përkohshme të vitit. Për një periudhë kohore janë verifikuar kushtet që çuan në regjistrimin e tyre origjinal, miratimit, nëse është e nevojshme, të variacioneve (ndryshimeve) të duhura.

Për ushtrimin nën auditim, të hyrat e shtyra janë zëri kryesor i obligimeve në Pasqyrën e pozicionit financiar. Këto të hyra ju përkasin obligimeve që ka FPPK për periudhat vijuese për ushtrimin e aktiviteteve të saja normale. Njihen në Pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet.

Të hyrat e shtyra janë obligime për projektet të cilat FPPK, do ti përfundojë, projektet këto te filluara më parë dhe do ti përfundojë në periudhat në vijim për mjetet e marra nga donatorët siq është Departamenti i MRKS, Kufizimeve të Klubeve, sponsoret tjerë.

6. Fondi i FPPK

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fondi i bartur me 01.01	(8,672)	9,153.40
Teprica/mungesa e fondit	(33,262)	(17,816.14)
Gjithësej ekuiteti	(41,934)	(8,662.74)

Fondi i përket tepricës pozitive nga periudhat paraprake që ka ndodhë si rezultat i aktiviteteve pozitive që ka ushtruar FPPK dhe përfitimet nga donacionet dhe dhuratëdhënësit.

II. PASQYRA E TË ARDHURAVE

7. Donacionet dhe të ardhurat	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të Hyrat për projekte	306,088	132,046
Sponsorizimet	12,000	1,000
Të hyrat tjera	1,050	120
Gjithsej të hyrat	319,138	133,166

Për vitin 2024 Federata ka krijuar të ardhura për shpenzime programore nga hyrjet nga donacionet, kotizime dhe sponsorët në vlerë prej 319,138 euro.

Hyrjet ju përkasin këtyre donatorëve:

Përshkrimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Te hyrat nga kotizimet e klubeve	8,790	3,720
Te hyrat nga Departamenti MKRS	219,000	115,218
Te hyra nga sponsorizimet	12,000	1,000
Te hyra nga ankesa në bord te apelit	25	25
Te Hyrat nga provimet per refer	220	280
Te hyra nga Donacione ETTU/ITTF		1,857
Te hyrat WTT Kosova	76,997	
Te hyra nga KOK		6,457.56
Te hyra nga Superpuna	1,056	4,488.00
Te hyrat tjera	1,050	120
Gjithsejtë të hyrat:	319,138.00	133,165.67

FPPK, donacionet i ka realizuar për zhvillimin e këtyre aktiviteteve sipas shpalosjes ne shënimet ne vazhdim:

a) Te hyrat nga Departamenti

Të hyrat nga Departamenti në vitin 2024 janë bërë sipas memorandumit të bashkëpunimit për vitin 2023, pra është njohur e hyra në tërësi që ka qenë e paraparë në memorandum në 4 pjesë.

b) Të hyrat nga kuotizimet e klubeve

Të hyrat nga kuotizimi i klubeve janë ndarë sipas kategorisë në të cilën konkurrojnë klubet kështu që i kemi këto lloje të hyrash

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kotizimet e Ekipeve te superliges	1,200	800.00
Kotizimet e ekipeve juniorve	50	50.00
Kotizimet e ekipeve te liges se pare	1,200	800.00
Kotizimet e ekipeve te liges se dyte	3,150	1,400.00
Kotizimet e ekipeve te liges se femrave	550	
Kotizimet per individ	2,640	670
Gjithsej	8,790	3,050

c) Të hyra nga Donacionet e ETTU-së – ITTF-it

Federata Europiane e Pingpongut (ETTU) dhe Federata ndërkombtare e Pingpongut (ITTF) gjatë vitit 2024 kanë ndihmuar federatën e Pingpongut me donacion në natyrë duke mbuluar shpenzimet për aktivitete të ndryshme ndërkombtare.

d) Të hyra nga sponsoret

Të hyrat nga sponzoret kane te bëjnë me te hyrat nga dashamirë të pingpongut të cilët kanë ndihmuar federatën e pingpongut me 12,000.00 si në vijim:

- VM3	5,000
- Tick Media	5,000
- Metal Kosova	2,000

8. Shpenzimet programore dhe operative

Për periudhën nën auditim, FPPK ka pasë shpenzime nga zhvillimi i aktiviteteve të veta në vlerë prej 352,399.95 euro. Politikat e FPPK janë që 244,201.64 euro apo shprehur ne përqindje 69.30% të shpenzimeve të ndodhura t'i klasifikojë për shpenzime programore, ndërsa 84,791.38 apo 24.06% të shpenzimeve të ndodhura t'i klasifikojë për kompensimet për punë profesionale, 10,555.23 apo 3.00% të shpenzimeve të ndodhura të i klasifikoj si shpenzime operative, 301.37 euro apo 0.09% shpenzime të tjera financiare ndërsa 12,599.33 euro apo 3.58% shpenzime të zhvlersimit.

Specifikacioni i shpenzimeve per vitin 2024:

SHPENZIMET PROGRAMORE

PROJEKTET KOMBËTARE

Shpërblimet për lojtarë, trajner dhe klube	15,260.00
Shpenzime për kupa, medalje për turne	3,178.00
Shpenzime marketing	11,114.04
Shpenzime për organizim te aktiviteteve	11,512.32
Shpenzime të antarsimit në KOK	300.00

PROJEKTET NDËRKOMBtare

ITTF – të ndryshme	109,050.82
ETTU – të ndryshme	11,292.69
BTTU – të ndryshme	14,049.13
MTTU – të ndryshme	4,694.54
Connect Liga	4,511.79
KOS-SHQ – KIM Senior	2,784.82
Fondi per zhvillim – shpenzimet per perfaqesuese, dhe ndihme klubeve	56,453.47
Gjithsej projekte kombtare dhe nderkombtare	244,201.64

SHPENZIME PËR KOMPENZIME DHE MEDITJE TË PERSONELIT

Kompenzim per sekretarin	10,876.72
Kompenzim per zyrtarin e garave	2,865.52
Kompenzim per zyrtarin e administrates dhe financave	4,986.70
Kompenzim per zyrtarin e mediave	1,705.14
Kompenzimi për fotograf	2,573.12
Meditje për Arbiter	3,957.56
Meditje per mbledhje të Bordit	4,940.90
Meditje per gjyqtar të ndeshjeve	15,655.22
Meditje per Komisione të ndryshme	3,104.04
Meditje per lojtar në aktivitete ndërkombtare	2,318.00
Meditje per pergjegjes në aktivtete vendore e ndërkombtare	5,941.64
Meditje per trajner për aktivitete të ndryshme	4,410.11
Meditje për aktivitete të vecanta	9,470.77
Meditje per mjek dhe teknik	690.05
Meditjet për vullnetar për wtt	2,713.28
Bursat për sportistë për vitin 2024	4,800.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	3,782.61
Gjithsej	84,791.38

SHPENZIME TJERA OPERATIVE

Furnizime të zyres	443.04
Shpenzim për ushqim dhe pije	1,451.26
Shpenzime transporti	4,816.99
Shpenzime të internetit	170.00
Shpenzime të telefonit	372.50
Shpenzime të Servisimit	85.00
Shpenzime të qirasë	1,311.50
Shpenzime të provizionit	1,116.94
Shpenzime të auditimit	708.00
Shpenzimet te zhdoganimi	80.00
Gjithsej	10,555.23

a) Shpenzimet programore

Ju përkasin shpenzimeve të cilat kanë ndodhë për Grantet e pranuar nga donatorët siç është Departamenti i sportit të MRKS dhe më detajishtë është shpalosë në shënimin 8 në këtë Raport.

b) Shpenzimet e menaxhimit, administratës dhe pagave

Këto shpenzime kanë ndodhë nga zhvillimi i aktiviteteve operuese të FPPK-së. Pranohen në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur (tepricave) dhe janë prezentuar në Pasqyrën e të ardhurave e cila është pjesë e këtij Raporti.

c) Shpenzimet e zhvlerësimit

Edhe këto shpenzime ju përkasin pasurive të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve operuese të FPPK - së. Pranohen në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur (tepricave) dhe janë prezentuar në Pasqyrën e të ardhurave e cila është pjesë e këtij Raporti.

9. Zotimet dhe kontigjencat

Sipas pohimeve të drejtimit, Sekretarit, nuk ka dhënë zotime dhe as nuk pret të ketë detyrime kontigjente.

10. Ngjarjet pas datës së Bilancit

FPPK-ja nuk ka prezentuar ndonjë rast që mund të ketë ndikim në Pasqyrat Financiare të datës 31 dhjetor të vitit 2024 deri në përpilimin e këtij raporti.

11. Vijimësia

FPPK, ka hartuar planin operativ për vitin 2025 me më shumë se 105 aktivitete të cilat i ka dorëzuar te Departamenti i Sportit.

Mundësia e vazhdimit të aktiviteteve të FPPK edhe për 12 (dymbëdhjetë) muajt e ardhshëm, në bazë të mjeteve të disponueshme, projekteve aktive dhe planeve të drejtimit nuk vihet në dyshim.

12. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga Kuvendi dhe janë autorizuar për publikim më 31.01.2025.